

VENDIM
Nr. 581, datë 3.10.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 253, DATË 6.3.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PLOTËSIMIT TË AKTEVE TË MARRJES SË TOKËS BUJQËSORE NË PRONËSI PËR FAMILJET BUJQËSORE NË FSHATRAT E ISH-KOOPERATIVAVE BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 253, datë 6.3.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 2 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-kooperativave bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me AMTP, paraqesin në njësinë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës gjendet toka bujqësore: ...”.

b) Në shkronjën “b” shtohet fjalia e dytë, me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur përdoruesit faktikë janë në pamundësi financiare për hartimin e planvendosjes së ngastrave të tokës bujqësore që kanë në përdorim, ato kryhen me shpenzimet e bashkive nëpërmjet topografëve të tyre; ...”.

2. Në pikën 21, fjalët “... nga një subjekt i licencuar ...”, hiqen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama